



Pranuar / Dorezuar Primjehoh/Prodato Received/Delivery	06.12.2022	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKAMSHUK	7345/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1315/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1315/2023 të datës 23.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

objekti Kela, kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike 'kërkese nga marrëdhënia e punës', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.12.2023 njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1315/2023 e datës 23.10.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Komunën e Ferizajt, i cili sipas akt emërimit të datës 20.07.2012 ka themeluar marrëdhënien punës në pozitën "Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës" pranë Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Ferizajt me koeficient 6, ndërsa me vendimin me numër 01 Nr.28/14 të datës 10.01.2014 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, ankuesit i është bërë transferimi i përhershëm nga Drejtoria e Inspeksionit në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit në pozitën e njëjtë "Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës" për shkak të shuarjes së Drejtorisë së Inspeksionit.

Ndërsa me datë 25.05.2018 për shkak të riorganizimit të administratës komunale, Kryetari i Komunës së Ferizajt ka marr vendimin me numër 01. Nr.233/18, me të cilin ankuesin e ka transferuar nga pozita „Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës“ në vendin e punës „Zyrtar i Njësisë për Informim“ në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia, duke filluar nga data

25.05.2018. Tutje me date 24.07.2019 pas përfundimit me suksese të procedurës së rekrutimit të datës 25.06.2019 ankuesi, është emëruar Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë sipas ndryshim dhe plotësim të Aktit të emërimit të datës 24.07.2019.

Ankuesi me datë 07.04.2023 ka parashtruar ankesë pranë organit të punësimit me pretendim ankimor lidhur me rregullimin e pozitës së punës dhe vërtetimit të marrëdhënies së punës nga viti 2012 deri në vitin 2018, gjegjësisht ka kërkuar që ndryshohet titulli i pozite nga „Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës“ në „Inspektor Komunal“ me arsyetimin se pozita „Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës“ nuk ka ekzistuar asnjëherë në organogram. Ndërsa Kryetari i Komunës së Ferizajt përmes shkresës zyrtare të datës 15.09.2023 i ka kthyer përgjigje në ankesën me numër 01-110.02-0031806.23 të datës 07.04.2023, përmes së cilës e ka njoftuar ankuesin se vërtetimi i datës 30.03.2023 lidhur me marrëdhënien e punës është lëshuar në bazë të dëshmive që posedon ankuesi në dosjen e tij personale.

Ankuesi shkresën zyrtare të datës 15.09.2023 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt e ka pranuar me datë 11.10.2023 ndërsa me datë 23.10.2023 i pa kënaqur me përgjigjen e datës 15.09.2023 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt ka parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me të cilën ka kërkuar rregullimin e pozitës së punës dhe vërtetimit të marrëdhënies së punës nga viti 2012 deri në vitin 2018, gjegjësisht ka kërkuar që ndryshohet titulli i pozitës nga „Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës“ në „Inspektor Komunal“ me arsyetimin se pozita „Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës“ nuk ka ekzistuar asnjëherë në organogramin e Komunës së Ferizajt gjegjësisht nga viti 2012 deri në vitin 2018 ti njihet përvoja e punës në pozitën „Inspektor Komunal“.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Ferizajt. Ndërsa Këshilli, me datë 03.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6654/2023 të datës 23.10.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vërtetimin me numër Nr.01-214/2023 të datës 30.03.2023; Përgjigjen e datës 15.09.2023; Vendimin me numër 01.Nr.233/18 të datës 24.05.2018; Vendimin me numër 01. Nr.226/16 të datës 01.08.2016; Vendimin me numër 01.Nr.281/14 të datës 10.01.2014; Ndryshimi dhe plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 24.07.2019; Vendimin me numër 01 Nr.233/18 të datës 24.05.2018; Vërtetimin me Nr.01-214/2023 të datës 30.03.2023; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Formularin për kërkesë apo ankesë; Ankesën e datës 07.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 03.11.2023; Akt emërimit të datës 20.07.2012; Përshkrimin e detyrave të punës të datës për pozitën e punës „Udhëheqës i Sektorit të Emergjencave në Shërbime Publike“; Kontratën e punës të datës 06.09.2016; Kontratën e punës të datës 07.09.2015; Listën e pagave për muajin Janar, Shkurt dhe Mars;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi Skender Kurti, është i punësuar në Komunën e Ferizajt, rrjedhimisht i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 25.06.2019 ushtron pozitën e punës si *“Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencia”*. I njëjti fillimisht ka themeluar marrëdhënien e punës sipas Akt emërimit të datës 20.07.2012 në pozitën *“Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* pranë Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Ferizajt, ndërsa me vendimin me numër 01 Nr.28/14 të datës 10.01.2014 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, ankuesit i është bërë transferimi i përhershëm nga Drejtoria e Inspeksionit në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit në pozitën e njëjtë *“Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* për shkak të shuarjes së Drejtorisë së Inspeksionit deri me datë 25.05.2018, kur ankuesi për shkak të riorganizimit të administratës komunale, është transferuar nga pozita *„Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* në vendin e punës *„Zyrtar i Njesisë për Informim”* në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia.

Ankuesi me datë 07.04.2023 ka parashtruar ankesë pranë organit të punësimit me pretendim ankimor lidhur me rregullimin e pozitës së punës dhe vërtetimit të marrëdhënies së punës nga viti 2012 deri në vitin 2018, ndërsa i pa kënaqur me përgjigjen e datës 15.09.2023 të Kryetarit të Komunës së Ferizajt me datë 23.10.2023 ka parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me të cilën ka kërkuar rregullimin e pozitës së punës dhe vërtetimit të marrëdhënies së punës nga viti 2012 deri në vitin 2018, gjegjësisht ka kërkuar që ndryshohet titulli i pozitës nga *„Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* në *„ Inspektor Komunal”* me arsyetimin se pozita *„Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* nuk ka ekzistuar asnjëherë në organogramin e Komunës së Ferizajt gjegjësisht nga viti 2012 deri në vitin 2018 ti njihet përvoja e punës në pozitën *„Inspektor Komunal”*.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit që ti ndryshohet titulli i pozitës nga *„Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* në *„ Inspektor Komunal”* me arsyetimin se pozita *„Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* nuk ka ekzistuar asnjëherë në organogramin e Komunës së Ferizajt gjegjësisht nga viti 2012 deri në vitin 2018 ti njihet përvoja e punës në pozitën *„Inspektor Komunal”*, Kolegji gjatë rishqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi fillimisht ka themeluar marrëdhënien e punës në Komunën e Ferizajt, në pozitën e punës *“Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* në Drejtorisë së Inspeksionit me koeficient të pagës gjashtë (6), duke nënshkruar Aktin e Emërimit të datës 20.07.2012 pa asnjë vërejtjeje, ndërsa për shkak të riorganizimit të administratës komunale Kryetari i Komunës së Ferizajt, me datë 10.01.2014 përmes vendimit me numër 01 Nr.28/14 ankuesin e ka transferuar nga Drejtoria e Inspeksionit në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit në pozitën e njëjtë *“Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* deri me datë 25.05.2018, kur ankuesi është transferuar nga pozita *„Zyrtar për Ekzekutimin e Vendimeve të Komunës”* në vendin e punës *„Zyrtar i Njesisë për Informim”* në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia, andaj si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i qëndrueshëm, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 20.07.2012 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *“Zyrtar për Ekzekutimin e vendimeve të Komunës”*, dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me pozitën e caktuar nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të ndryshimit të pozitës apo vendin e punës deri me datë 07.04.2023, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar në Këshill lidhur me pretendimin që t'i bëhet ndryshimi i pozitës



“Zyrtar për ekzekutimin e Vendimeve” në pozitën e “Inspektorit komunal” nga viti 2012 deri ne vitin 2018, është ushtruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 20.07.2012), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin” si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: “...Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”. Rrjedhimisht meqenëse ankuesi nga data e nënshkrimit të Akt Emërimit të datës 20.07.2012 e deri me datë 07.04.2023 nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik përkundër faktit që i njëjti ka qenë në dijeni lidhur me pozitën e caktuar, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa me numër A.nr.1315/2023 e datës 23.10.2023 e parashtruar nga ankuesi Skender Kurti në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, gjegjësisht e njëjta është në kundërshtim me dispozitat e nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1315/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së